

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

“PËR TREGUESIT STATISTIKORË TË VLERËSIMIT E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE, SI EDHE PERIODICITETIN E MBLEDHJES SË TYRE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt akt ka për qëllim monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave, të masave e veprimeve, në zbatim të legjislacionit, strategjive dhe programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror, vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve, vlerësimin e ndikimit të politikave dhe hartimin e politikave dhe programeve për mbështetjen e grupeve në nevojë.

Objektivat që synohen të arrihen kanë të bëjnë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore si edhe përgatitjen e raporteve, në bazë të të cilave përcaktohen nevojat mbështetje me pagesa dhe shërbime të familjeve dhe individëve në nevojë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti hartohet brenda programit analitik të akteve për IV mujorin e dytë të vitit 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektakt hartohet për të përcaktuar:

- i) mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore që realizohen në nivel vendor e kombëtar;

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”.

- ii) mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të objektivave, të masave e veprimeve, në zbatim të legjislacionit, strategjive dhe programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror;
- iii) mënyrën e vlerësimit të efektivitetit të përdorimit të fondeve, në zbatim të politikave dhe programeve të mbrojtjes shoqërore;
- iv) mënyrën e vlerësimit të ndikimit të politikave në uljen e varfërisë, shmangien e përjashtimit shoqëror dhe garantimin e mundësive të barabarta;

Nuk parashikohen të dalin probleme në zbatimin e projektaktit.

Zbatimi i projektaktit garanton:

- i) zhvillimin dhe përmirësimin e politikave dhe programeve për mbështetjen e grupeve në nevojë nga ana e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe strukturat në varësi të saj, përmes të dhënave statistikore të grumbulluara dhe përpunuara si edhe raporteve të hartuara.
- ii) përcaktimin e nevojave për mbështetje me pagesa dhe/ose shërbime të familjeve dhe individëve në nevojë;
- iii) vlerësimin e nevojave për shërbime të reja të përkujdesit shoqëror, në përputhje me kërkesat dhe burimet për ngritjen e tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektakt hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 3, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 31, shkronja c e ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN

Projektakti nuk ka synim përputhshmërinë me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”.

Në pikën 1 të projektaktit parashikohet qëllimi i projektaktit lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore.

Në pikën 2 parashikohet nevoja për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, si dhe hartimit të raporteve nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe strukturat në varësi të saj.

Në pikat 3, 4 dhe 5 parashikohet afati kohor dhe periodiciteti i dërgimit të të dhënave statistikore për programin e ndihmës ekonomike, pagesave të aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, si edhe modularët 1, 2 dhe 3 që i bashkëlidhen projektaktit mbi të dhënat statistikore për familjet e skemës së ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, dhe përfituesit e shërbimeve të përkujdesit social, që mbështeten me pagesa dhe/ose shërbime, si dhe për fondet e përdorura.

Në pikën 6 parashikohet afati kohor dhe periodiciteti i dërgimit të të dhënave statistikore për shërbimet e përkujdesit shoqëror të ofruara dhe numrin e përfituesve që personat juridikë, publikë dhe privatë, dhe organizatat jofitimprurëse të licencuara dërgojnë në strukturat e Shërbimit Social Shtetëror.

Në pikën 7 parashikohet afati kohor brenda të cilit Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, do të vlerësojë, përpunojë dhe standardizojë të dhënat e grumbulluara nga bashkitë, dhe dërgimin e tyre tek Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Në pikën 8 që bashkitë, personat juridikë, publikë dhe privatë, e organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, të dërgojnë një kopje të raportit të të dhënave, pranë sektorit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qark.

Në pikën 9 parashikohet që Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror mund të lidhë akt marrëveshje me institucione të tjera për shkëmbimin e të dhënave statistikore, periodike.

Në pikën 10 parashikohet që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara t'ia dërgojë Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe Institutit të Statistikave.

Sipas pikës 11 ministri përgjegjës për çështjet sociale ngarkohet të nxjerrë udhëzime për mënyrën e paraqitjes së të dhënave statistikore për programin e ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për treguesit statistikorë të vlerësimit e monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre".

Në pikën 12 parashikohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

Në pikën 13 parashikohet që Vendimi nr. 617, datë 07.09.2006 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky projektakt dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore dhe Institutin e Statistikave.


IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektakt nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI

Ogerta Manastirliu



Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për treguesit statistikorë të vlerësimit e monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre".